



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE**



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatori ekonomik “W-CENTER” shpk me NR NIPT- K63029402A me Administrator Z. Bledar Shemaj, me adresë: Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2 katesh ,Perball "Gjimnazit Perikli Ikonomi", Fier.

Lloji i procedurës se prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-43707-02-05-2018

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Blerje kimikate, për UKT sha”

Fondi limit: 89,795,578 (tetëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 9 muaj duke nisur nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Data e zhvillimit të tenderit është: 01.03.2018 ora 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: [Nr. 06 DATE 12.02.2018](#)

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “2-MJ ” shpk NR NIPT-
L223190130
Vlera: nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2. Operatori ekonomik ”T&M Chemical Distribution” sh.p.k NR NIPT- L41823009V
Vlera: nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

3. Operatori ekonomik “**2 AT**” shpk **NR NIPT- K14019001H**
Vlera: 46.837.500(dyzetë e gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind)lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “**DIMEX**” sh.p.k **NR NIPT- J61805519O**
Vlera: 50.756.250(pesëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë)lekë pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik “**ATLANTIK-3**”sh.p.k **NR NIPT- K22218003V**
Vlera: 58.500.000(pesëdhjetë e tete milion e pesëqind mijë)leke pa TVSH.
6. Operatori Ekonomik “**W-CENTER**” sh.p.k **NR NIPT- K63029402A**
Vlera: 83.928.750 (tetedhjetë e tre milion e nentëqind e njëzetë e tete mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Të skualifikuar:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “2-MJ ” shpk me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “2MJ” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 9, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “2-MJ” Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 9, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “T&MCHEMICALS” shpk me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**T&MCHEMICALS** ” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 9, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e

ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**T&MCHEMICALS**” Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 9, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “2 AT” shpk me vlerë të ofertës 46.837.500 (dyzetë e gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/ në pikën 1 si më poshtë cituar:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Operatori ekonomik në Sistemin elektronik të app-së ka paraqitur shtojcën 8 “Deklaratë mbi gjendjen Gjyqësore” ku ndër të tjera ka deklaruar se operatori ekonomik “2- AT” sh.p.k nuk është i dënuar për shkelje penale, si dhe nuk është i dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për përmbushjen e pikës 1 të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit gjykon se nuk ka paraqitur dokumentacion sipas setit të DST që APP ka publikuar në eeb.app.gov.al dhe që janë detyruara për zbatim nga cdo AK në procedurat e vitit 2018 e në vijim.

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nen 41, pika 1, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”, si edhe Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, KVO vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori “2- AT” shpk nuk është i saktë dhe sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi.

Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit e si rrjedhojë edhe operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta.

Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi e është publikura vendimi I APP për miratimin e DST për vitin 2018, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe rrjedhimisht, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të plotësojnë këto dokumenta.

KVO konstaton gjithashtu se, nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Prandaj, “2 AT” sh.p.k duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

- ***Së dyti AK në Dokumentat Standarte të Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:***

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, shoqëria “2 AT” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

“Vërtetim debie” nr. 132 prot, datë 26.02.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “2-AT” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me Kod KR0A0602260028118 KR0D060001628438... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 26.02.2018 pa përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2018”. Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht **muajin Janar 2018**.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “2- AT” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 06.02.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 01.03.2018 brenda këtij afati operatori ekonomik e kishte detyrim të kishte bërë pagesën e faturës së muajit Janar 2018 si dhe të pajisej me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik DIMEX sh.p.k me oferte 50. 756.250(pesëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë)lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- ***Së pari AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë cituar:***

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, shoqëria “DIMEX” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

“Vërtetim debie” nr. 240 prot, datë 26.01.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit z.Dhimiter Roko perfaqesues ligjor I operatorit ekonomik “DIMEX”sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me Kod DU0A020105026064..... DU0A010088640237 rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 26.01.2018 duke përfshirë faturën koherente të muajit Dhjetor 2017”.

Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Janar 2018.
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “DIMEX” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma

“c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike **përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik**, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 06.02.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 01.03.2018 brenda këtij afati operatori ekonomik e kishte detyrim të kishte bërë pagesën e faturës së muajit Janar 2018 si dhe të pajisej me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.** Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike **përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik**, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm

- **AK në Dokumentat Standarte të Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë cituar:**

- a. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit e paraqitur në sistemin elektronik, KVO verën se operatori ekonomik DIMEX sh.p.k **nuk ka paraqitur** shtojcën 6 (deklaraten mbi specifikimet teknike) si dhe shtojcën 7 (deklaraten mbi konfliktin e interesit) të kërkuara në shtojcën 9 të DT.Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik lidhur me shtojcat është i paplotë, rrjedhimisht i pavlefshëm.

- **Së treti AK në Dokumentat Standarte të Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:**

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me një vlerë sa 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose 17,959,115 (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) Leke pa TVSH dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në

deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Kontratë
 2. Faturat tatimore të shitjes të cilat do të përmbajnë (datën, shumën si dhe sasinë e mallrave të furnizuar) me TVSH
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Faturat tatimore të shitjes të cilat do të përmbajnë (datën, shumën si dhe sasinë e mallrave të furnizuar) me TVSH

Nga analiza e bërë vemë re se shoqëria DIMEX shpk nuk ka paraqitur për të vërtetuar përvojën e suksesshme dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit.

Pra sa më sipër cituar shoqëria DIMEX shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket Përvojës së suksesshme, dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1/a dhe pika 1/b, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b) Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

- ***Së katërti AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë cituar :***

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesi Lejen e Importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të paraqesi certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, për analizë toksikologjike për produktet që prokurohen (3 muajve të fundit).

2.3.10 Një punësim mesatar i të paktën 5 (pesë) personave, për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017.
- List pagesat e punonjësve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

2.3.11 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjeti.

- Për punonjësën “Kimist” dokumentat që duhet të paraqes janë: diplomë, CV dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar) si dhe të figurojë në listpagesa e shoqërisë.

- Për punonjësin “Drejtues mjete” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e shoqerisë.

Nga shqyrtimi I dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik DIMEX ,KVO konstaton se nuk ka paraqitur dokumentacion për të përmbushur kriteret e kerkuara ne DST.

Pra sa më sipër cituar shoqëria DIMEX shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket Përvojës së suksesshme, dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1/a dhe pika 1/b, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ATLANTIK-3”sh.p.k me oferte 58.500.000(pesedhjetë e tete milion e peseqind mije)leke pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- ***Së pari Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 2.3.11 si më poshtë cituar:***

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe **një drejtues mjete**.

Për punonjësin “Drejtues mjete” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e shoqerisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne sistemin elektronik, KVO konstaton se operatori ekonomik

„ATLANTIK-3“ sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion për te permbushur kriterin 2.3.11 te kerkuar ne shtojcen 9.

Nga sa më sipër rezulton se shoqëria “Atlantik 3” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 2.3.11, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

- **Së dyti, Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 2.3.12 ka kërkuar si më poshtë cituar:**

Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose qera mjetin tip “Bot” ose cistern të çertifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende te rrezikshme”, plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetin e pajisjet teknike të deklaruar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne sistemin elektronik KVO konstaton se operatori ekonomik „ATLANTIK-3“ sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë mjet për te permbushur kriterin 2.3.12 te kerkuar ne shtojcen 9.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga ana e Operatorit Ekonomik lidhur me mjetet , me pikën 2.3.12 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

- **Së treti, AK në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 2.3.12 pika f) ku citohet se :**

f) Mjeti nuk është i angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk është i deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Nga shqyrtimi I dokumentacionit ne sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik ATLANTIK-3 sh.p.k nuk ka paraqitur (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga ana e Operatorit Ekonomik lidhur me mjetet , me pikën 2.3.12 gërma f është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

- Së katërti, AK në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/kapaciteti ekonomik pika 2.2/1 ku citohet:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2014,2015,2016), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me **Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.**

Nga shqyrtimi I dokumentacionit në sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik ka paraqitur Akt-Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar të bilanceve vetëm për vitin 2015 ndërsa për vitet 2014 dhe 2016 KVO verën se operatori ekonomik nuk ka paraqitur akt ekspertimi për 2 vitet e sipërcituara.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur elektronikisht nga shoqëria Atlantik 3 shpk është i paplotë pasi nuk janë përmbushur Kriteret e Veçanta të Kualifikimit /Kapaciteti Teknik pika 2.2/1 për këtë arsye dokumentacioni i paraqitur lidhur Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2014,2015,2016), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me **Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, më konkretisht bilancet e paraqitura nga shoqëria , bilanci i vitit 2014 dhe bilanci i vitit 2016 janë paraqitur pa akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar** rrjedhimisht dokumentacioni është paraqitur i është i paplotë, për rrjedhojë nuk mund të quhet i vlefshëm nga autoriteti kontraktor.

- Së katërti, AK në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 2.3.6 ku citohet se :

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e prodhuesit që vërteton konformitetin e produktit në prokurim me normat Europiane (EN-883;2006) dhe (EN;939;2009) dhe (EN 901;2013) produkte kimike për tregëtimin e produkteve për trajnimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor conform mallrave europiane.

Nga verifikimi I dokumentave të operatorit ekonomik të ngarkuara në sistemin elektronik të app-së rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur **asnjë lloj dokumentacioni** për të përmbushur pikën 2.3.6 të kërkuar nga AK, në dokumentat standarte të tenderit për **rrjedhojë dokumentacioni I pavlefshëm.**

- Së pesti, AK në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 2.3.9 ku citohet se :

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e analizës nga institute I Shëndetit Publik për analizë Toksikologjike për produktet që prokurohen (tre muajve të fundit)

Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur analizë për elementin hipoklorit natriumi e cila I përket datës 12.01.2017, komisioni I vlerësimit të ofertave konkludon se analiza e paraqitur është jashtë afatit të vlefshmërisë pra jashtë tre muajve të fundit. Gjithashtu nga verifikimi në dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik rezulton se për dy elementët e tjerë dhe përkatësisht : acid klorhidrik dhe poliklorur alumini nuk ka paraqitur analizën nga ISHP. Dokumentacioni lidhur me pikën 2.3.9 do të konsiderohet i është i paplotë, për rrjedhojë **nuk mund të quhet i vlefshëm** nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të

Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri,

Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.

Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatori ekonomik, **“W-CENTER” shpk me NR NIPT- K63029402A** me Administrator Z. Bledar Shemaj me oferte ekonomike me vlerë **83.928.750** (tetedhjetë e tre milion e nentëqind e njëzete e tete mije e shtatëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH. se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.03.2018

Ankesa: Është paraqitur ankesë nga ana e OE “2 AT” Sh.p.k me Nr. 8534 prot, më datë 12.03.2018, të cilës i është kthyer përgjigje nga ana e AK me anë të shkresës me Nr. 8534/1prot, më datë 12.03.2018, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

Gjatë afatit kohor për ankimim në KPP, është paraqitur ankesa nga ana e OE “2 AT” Sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit Nr. 334 datë 18.05.2018 vendosi: *“Të mos pranoj ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “2 AT” Sh.p.k.”*

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

REDI MOLLA